



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13746 Prot

Lezhë, më 01 / 09 /2023

**VENDIM**

**Nr. 31, Datë 30. 08. 2023**

**Për një shtesë e ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të emergjencës për “Rindërtimin e urës në fshatin Kodër Mulliri, Njësia Administrative Shëngjin”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

**1.** Miratim i një shtese në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2023, si më poshtë:

**1.a-**Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2023 në shumën 16,199,389 lekë, fond i akorduar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

**1.b-**Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Mbrojtja Civile” , si më poshtë;

-Gr.17, Prog.10910, Kap.01, Art./llog.ek.604 në shumën 16,199,389 lekë, fond i cili do të përdoret për “Rindërtimin e urës në fshatin Kodër Mulliri, Njësia Administrative Shëngjin”.

**2.** Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 1,988,566 lekë, si më poshtë;

**2.a-**Të pakësohet: Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.602 në shumën 1,988,566 lekë me emërtim: “Ndërrhyrje parandaluese”.

**2.b-**Të shtohet: Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.231 në shumën 1,988,566 lekë, fond i cili do të përdoret për “Rindërtimin e urës në fshatin Kodër Mulliri, Njësia Administrative Shëngjin”.

3.Fondi gjithsej në shumën prej 18,187,955 lekë që do të përdoret për financimin e Rindërtimit të urës në fshatin Kodër Mulliri, Njësia Administrative Shëngjin”, detajohet për përdorim si më poshtë:

- 3.a-Për punime ndërtimi në shumën 17,417,955 lekë.
- 3.b-Për mbikqyrje punimesh në shumën 530,000 lekë.
- 3.c-Për kolaudim punimesh në shumën 120,000 lekë.
- 3.d-Për oponencën teknike në shumën 120,000 lekë.

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**  
**NDUE LULI**



Prot 13746//  
dt 8-9.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 685/16 Prot.

Lezhë, më 06. ep.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma "b" të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.9936, datë 26.08.2008 "Për menagjimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", në VKM-në nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" si dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.31, datë 30.08.2023, të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të emergjencës për "Rindërtimin e urës në fshatin "Kodër Mulliri", njësia administrative Shëngjin".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

